

**Prof. Dr. Nevila NIKA**

Universiteti European i Tiranës

**Dr. Ardiana TOPI**

Autoriteti për Informimi mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

## **PAJIMET E MJESHTËRISË SË ARKIVISTIT NË STROFULLËN E ALKIMISTIT DIGJITAL**

Në ditët e sotme, përdorimi i teknologjisë së informacionit, gjithnjë e më shumë është bërë pjesë e pandarë e punës tonë të përditshme. Ajo gjen aplikim në të gjitha fushat e jetës dhe ka efekte të ndjeshme pavarësisht nga madhësia e institucionit apo organizatës.

Shkencëtari amerikan, Paul Saffo, në një intervistë është shprehur “Është bindja ime se teknologjia nuk udhëheq ndryshimin. Ajo thjesht mundëson ndryshim dhe krijon opsione dhe oportunitete për individët, komunitetet dhe për kulturat në tërësi që zgjedhin ta shfrytëzojnë atë. Dhe është kjo përgjigja jonë për teknologjitë që udhëheqin ndryshimin. Me fjalë të tjera, në fillim ne shpikim teknologjitë dhe më pas i përdorim ato për të rishpikur vetveten”<sup>1</sup>.

Këto fjalë të Paul Saffo, ruajnë ende të gjithë pozicionin për të vendosur me korrektësi raportin midis një disipline shkencore (ose çfarëdo veprimtarie njerëzore) dhe oportunitetet që mund të garantojë ajo. Pra duhet të jenë zgjedhjet e atyre, që zotërojnë nga pikëpamja kulturore e teknike (në rastin tonë arkivistët) për të përdorur teknologjinë, dhe jo anasjelltas.

Për një varg arsyes, pikërisht në këtë perspektivë, arkivistika është thirrur po aq shumë sa disiplinat e tjera në një ballafaqim të veçantë të brendshëm, që në fund e ka vënë në kushte që të ndërtojë një raport të lodhshëm, por fitimprurës, me teknologjinë e informacionit. Ky raport ekziston tashmë prej shumë kohësh dhe ka prodhuar frute, të cilat edhe pse në fillim kanë hasur vështirësi të shumta, kanë ardhur deri në kohët e fundit duke u maturuar. Por në botën digjitale, nuk është vërtetë ar gjithçka që shkëlqen.

Përdorimi gjithnjë e në rritje i teknologjive digjitale në sferën e kërkimit e të komunikacionit ka detyruar edhe arkivat, dhe çdo institucion tjetër të kësaj natyre, që të ndërtojnë mjete e të gjejnë rrugë të ndërsjella bashkëpunimi.

Por natyrisht nuk ekziston një kompjuter i Arkimit Pitagorik, në të cilin nga një anë futim këtë apo atë problem, dhe nga ana tjetër na dalin zgjidhjet. Teknologjia nuk thjeshtëzon automatikisht proceset komplekse dhe kjo duhet nënvizuar mbi të gjitha në sektorin e arkivistikës, në brendësi të të cilit aplikimi i teknologjisë në nivele të ndryshme imponon përdorimin e një refleksioni konstant, i drejtuar për të dalluar ndryshimet dhe për të analizuar në mënyrë kritike dështimet. Fjala magjike “*programim i ndërgjegjshëm*”, do të thotë kapacitet për të përkufizuar qysh në nisje me qartësi objektivat, të cilat synojmë të arrijmë, duke gjetur natyrisht edhe mjetet e duhura. Pra, duhet evituar rënia në një *lumë të përvëluar* të zgjidhjeve teknologjike që janë në dispozicion, dhe të tërhiqesh *në det* pa mundur të kontrollosh të papriturat. Pikërisht duhet të dish të “qeverisësh” teknologjinë, e të mos qeverisesh prej saj, edhe pse të ndërgjegjshëm se një përballje e qetë me teknologjinë e informacionit mundet në shumë raste të zbulojë zgjidhje, të cilat arkivistika e vetme nuk do të ishte në gjendje t’i gjente.

Afërsia fonetike e ndoshta edhe semantike e fjalëve alkimist / arkivist i përngjan bukur një *tigani* të madh ku gjenerohen pozicione të ndryshme të arkivistikës në erën digjitale.

Por duke u larguar nga metafora e mësipërme, mund të themi qysh në fillim se, cilësia e burimeve teknologjike që sot janë të disponueshme e bën absolutisht të papërfillshëm problemin e kompleksitetit të pasurisë arkivore, për sa i përket përdorimit të teknologjisë. Sot jemi përballë faktit se teknologjia është në gjendje t’i përgjigjet plotësisht kërkesave, (nganjëherë edhe pak perverse...) të komunitetit të arkivave. Kjo nuk do të thotë se raporti i trazuar midis arkivave e teknologjisë së informacionit është përfundimisht i zgjidhur paqësisht. Teknologjia, në fakt, i lëviz gati përditë kufijtë e saj, duke evokuar sfida të reja dhe duke kërkuar oportunitete, të cilat mbajnë në një tension të pandërprerë dhe të interesuar në mënyrë të vazhdueshme pjesën më të madhe të komunitetit arkivistik.

Por ajo që është e qartë ka të bëjë me faktin se kur flitet për të “qeverisur” teknologjinë në kuadrin arkivistik, hamendësohet në analizë të fundit kapaciteti për të përkthyer në shprehje e përmbajtje digjitale rolin e ndërmjetësimit.

Ky rol ka qenë dhe është ushtruar nëpërmjet organizimit e përshkrimit të

fondeve arkivore, realizimit të mjeteve për kërkim (udhërrëfyes, inventarë, skedarë tematikë, sistematikë dhe emërore, katalogë, tregues emëror e gjeografikë, etj.), si edhe natyrshëm falë raportit fizik midis njerëzve, arkivistë e studiues, që komunikojnë në sallat e studimit. Shpërndarja e mjeteve digjitale, veçanërisht atyre telematike që potencialisht minojnë këtë raport, sikur hedhin në rrjet arkivat pa arkivistë, mund të ketë pasoja të rëndësishme antropologjike mbi përdorimin korrekt të burimeve arkivore. Dematerializimi, i nënkuptuar jo aq si transferim i suporteve, sa si nxjerrje nëpërmjet digjitales të praktikave e zakoneve profesionale, na vë përpara një serie problemesh jo gjithnjë të lehta për t'u zgjidhur dhe që, gjithsesi, duhet të vlerësohen me kujdesin ndaj aktit të projektimit të tipologjive të ndryshme në dispozicion.

E kur flasim për digjitalizim arkivor nuk mund të mos sjellim ndër mend shprehjen: “*Rubet për t'u këshilluar*”. Ky fakt nënkupton domosdoshmërinë e përsosjes së vazhdueshme të aparateve informative, si në cilësi, ashtu edhe shumëllojshmëri, për të bërë të mundur që kërkimi arkivor të plotësojë kërkesat e nevojat e të gjitha kategorive të individëve, të cilët u drejtohen arkivave të të gjitha niveleve e tipologjive.

Kërkimi arkivor mund të jetë një aventurë tërheqëse, një eksplorim i vërtetë në territore të panjohura dhe gjithnjë plot të papritura edhe për ata me më përvojë, por që paraqet, pa asnjë dyshim, pika të dobëta. Arkivi me vështirësi i përgjigjet menjëherë ngacmimeve të atij që kërkon të mbledhë informacion prej arkivit.

Nganjëherë përgjigjet, pra dokumentet, të cilat shkojmë për t'i kërkuar, strehohen në cepa të humbur e nuk dalin në pah menjëherë, pasi për arsye të ndryshme janë në vende të tjera nga ato që kemi menduar se duhej të ishin. Ndoshta ndonjëherë përgjigjet thjesht nuk ekzistojnë ose nuk arrijmë t'i gjejmë, edhe kjo gjë duhet marrë parasysh. Puna e arkivit është një kërkim, që procedon gati gjithnjë me përafërsi të njëpasnjëshme dhe kërkon përvojë, durim dhe, pse jo, edhe pak fat, gjë që të tjerë e quajnë *serendipity*, apo arti i të bërit zbulime të mëdha të rastësishme ose me fat, ndërsa kërkohej diçka tjetër. Është gati e pabesueshme që të trokasësh në një institucion, i cili ruan pasuri dokumentare, e pasi të kërkosh një X dokument, të marrësh përgjigjen: “*si urdhëron, menjeherë!*”.

Arkivat nuk janë biblioteka e muze të përbëra nga objekte të mirëpërcaktuara, janë, përkundrazi, siç e dimë të gjithë, komplekse, nganjëherë shumë të mëdhenj, me dokumente që është e vështirë të përshkruhen në tërësinë

e tyre, dhe për rrjedhojë është e pamundur të njihen apriori tërësitë e të dhënave që ato përmbajnë.

Shkurtimisht, për të bërë kërkim nevojitet përvojë e kompetencë, por edhe fantazi e këmbëngulje. Natyrisht ka raste që kërkimi është më i lehtë e i shpejtë, ose raste kur kërkuesi drejtohet për tek pistat e mundshme të kërkimit e më pas vazhdon vetë, por jo shumë shpesh ndodh kjo gjë. Ndhma e arkivistit është pothuaj gjithnjë përcaktuese për ata, të cilët paraqiten në derën e një arkivi.

Për këto arsye gjithmonë në kërkimin arkivor një suport, prej të cilit nuk hiqet dorë lehtësisht, është ai i ndërmjetësimit që arkivistët ushtrojnë midis pasurisë dokumentare arkivore dhe nevojave të përdoruesve. Ekziston, mbi të gjitha, edhe një ndërmjetësim fizik, një shërbim reference i garantuar për të gjithë përdoruesit. Por krahas dhe së bashku me ndërmjetësimin fizik një rol të rëndësishëm luan disponibiliteti i atyre të cilat quhen *mjetet e kërkimit* ose *instrumentet e pajës* së fondeve arkivore. Për të kryer një kërkim nevojiten, përveç suportit njerëzor, mjetet thelbësore për t'u orientuar, që të lejojnë deshifrimin e mesazheve nganjëherë në një kodik dhe për të mësuar të lexosh shenjat e fshehura. Mjetet e kërkimit, përtej dinamikës komplekse të tyre tekniko-shkencore, nuk janë volume, lista ose baza të dhënash të tejmbushura me numra e përshkrime sintetike, por ato janë portale të vërteta të cilat shpalosen në detin informativ të fondeve.

Këto mjete kërkimi, edhe pse tradicionalisht janë krijuar në letër, gjithnjë e më shumë po migrohen në formatin digjital, sipas zgjidhjeve të ndryshme teknologjike. Në fillim të çfarëdolloj kërkimi dokumentar qëndron pikërisht verifikimi i disponibilitetit të mjeteve të kërkimit që i përkasin një fondi ose fondeve, objekt i vetë kërkimit. Në mungesë të këtyre suporteve kërkimi do të jetë pa asnjë mëdyshje i penalizuar.

Ndërmjetësimi dhe mjetet e kërkimit, shkurt, janë leja e nevojshme për t'u futur në territoret e burimeve të gjuetisë së informacioneve që nevojiten.

Një arkivist i mirë nuk duhet të dashurohet me dokumentet që përshkruan, as edhe të zgjatet me leximin kur nuk është e nevojshme, na mëson edhe njëherë Paola Caruçi, dhe nganjëherë dikush harron se cilësitë më të mëdha të një arkivisti janë ato të *analizës* dhe *sintezës*.

Puna e lodhshme e përpunimit dhe organizimit të fondeve arkivore nuk do të kishte kuptim nëse nuk do të finalizohet si një produkt në funksion të lehtësimit të kërkimit, i çfarëdo lloji qoftë ai. Tradita arkivistike ka përpunuar në të kaluarën

modele efikase të mjeteve të informimit dhe kërkimit në arkiva. Këto mjete kanë ende sot të gjithë vlerën e tyre, por për arsyt që thamë më lart, sot ndoshta ka vend për ndonjë rishikim të mundshëm. Ky rishikim, ka të bëjë, më së shumti, me një qasje të re në drejtim të adaptimit të teknologjisë së informacionit për krijimin e tyre. Përfitimet që ofron ajo janë të ndjeshme në mënyrë të veçantë në shpejtësinë e kërkimit dhe komunikimit. Krijimi i mjeteve elektronike të kërkimit, së pari duke i harmonizuar logjikisht dhe më pas duke krijuar banka të dhënash apo, siç njihet ndryshe, duke digjitalizuar inventarët, katalogët, treguesit, etj., do të lehtësonte në mënyrë të ndjeshme punën e arkivistit si ndërmjetësues dhe do të shkurtonte kohën që studiuesit shpenzojnë në funksion të kërkimit.

Nisur nga faktet e mësipërme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA) të Shqipërisë, që në fillim të viteve '90, ka përkrahur përdorimin e teknologjisë së informacionit në proceset e punës arkivore. Me mbështetjen profesionale të Arkivave Federale Zviceriane, DPA ishte nga institucionet e para në Shqipëri dhe në rajon që instaloi një rrjet kompjuterik modern për kohën dhe adaptoi përdorimin e sistemi informacioni për arkivat. Ky sistem, funksional edhe në ditët e sotme, është ndërtuar mbi bazën e standardeve ndërkombëtare të përshkrimit arkivor ISAD(G) dhe sistemeve të informacionit për arkivat (OAIS). Në themel të këtij aplikacioni qëndrojnë tre shtyllat kryesore: fondkrijuesit, arkivat e përhershme dhe përdoruesit. Secila prej këtyre shtyllave ndërvepron në mënyrë organike me njëra-tjetrën duke u përshtatur sipas legjislacionit në fuqi për arkivat. Aplikacioni u popullua me të dhëna, të cilat në shumicën e tyre i përkisnin inventarëve të dosjeve të fondeve arkivore, duke krijuar në një farë mënyrë inventarët elektronik. Aksesit në çdo kompjuter pjesë e intranetit bëri të mundur përdorimin e inventarëve elektronikë si nga arkivistët, ashtu edhe nga studiuesit.

Por a ishte kjo një zgjidhje përfundimtare për sa i përket kërkimit të dokumenteve dhe të dhënave në arkiva?

Edhe pse procesi në fillimet e tij ishte shumë optimist, mbase edhe nga njohuritë e limituar në lidhje me zbatimin e teknologjisë së informacionit, ky proces rezultoi me krijimin e një baze të dhënash me miliona rekorde, por që ende nuk e zgjidhte përfundimisht problemin e kërkimit në arkiva. Kjo sepse kërkimi në arkiva është një proces kompleks dhe nuk mund të bazohet vetëm në një mjet kërkimi, siç është inventari i dosjeve, i cili, për hir të së vërtetës, është produkt i punës individuale të arkivistëve, dhe shpesh herë mund të ketë edhe

pasaktësi. Inventarët e dosjeve të fondeve arkivore përmbajnë, më së shumti, informacion përshkrues të përmbajtjes së njësisve përshkrimore. Ato nuk përmbajnë të dhëna të detajuara të dokumenteve, çështjeve apo individëve të veçantë, duke limituar hapësirat e kërkimit në dokumentet arkivore.

Vështirësi të kësaj natyre u hasën nga DPA në mënyrë të veçantë nga fluksit i madh i kërkesave të ardhura për dokumentet që përmbanin të dhëna rreth pronës. Kërkimi në nivel inventari dosjesh edhe pse i automatizuar nuk na çonte në emrat e pronarëve apo ish-pronarëve të cilëve u ishte sekuestruar prona gjatë periudhës së diktaturës. Për këtë qëllim, një ekip arkivistësh dhe informaticienësh modeluan kërkesat dhe zhvilluan një aplikacion i cili do të indeksonte dokumentet arkivore që kishin në përmbajtje të tyre të dhëna rreth pronës dhe pronarëve. Ky aplikacion, i cili deri në qershor 2016 numëronte rreth 1.6 milion rekorde, kapërceu pritshmëritë e grupit iniciator. Kërkimi i cili përpara zhvillimit të aplikacionit kërkonte disa muaj, dhe që në shumicën e rasteve rezultonte pa përgjigje, tani realizohej brenda disa sekondave.

Ajo çfarë është e rëndësishme të nënvizohet për të dy rastet e mësipërme, është fakti që të dy bazat e të dhënave u populluan me të dhëna të parapërgatitura manualisht nga arkivistët, pasi është e pamundur që një aplikacion të jetë në gjendje të lexojë dhe të identifikojë përmbajtjen e dokumenteve të shkruara me shkrim dore. Kjo gjë mund të eliminohet me dokumentet të cilat janë shkruar qoftë me makina shkrimi apo me kompjuter dhe që kanë cilësi të mirë. Ekzistojnë teknika të cilat mundësojnë digjitalizimin e dokumenteve të shkruara me makina shkrimi apo kompjuter në formë të editueshme dhe të kërkueshme. Këto teknika mundësojnë kërkimin me fjalë kyçe në përmbajtje të dokumenteve, duke u lejuar përdoruesve të arkivave kërkimin deri në nivel dokumenti. Një teknikë e cila mundëson diçka të tilla, ka të bëjë me krijimin e skedarëve të kërkueshëm nëpërmjet skanimit sipas metodës Optical Character Recognition (OCR). Dokumentet e digjitalizuara sipas kësaj teknike do të paraqiteshin në mënyrë vizuale si në Figurën 1.

Shembujt e ilustruar më lart janë vetëm një pjesë e vogël e përfitimeve që mund të marrin arkivat dhe arkivistët nga teknologjia. Këto përfitime janë akoma më të mëdha për dokumentet e ashtuquajtura “të lindura në formë digjitale”, të cilat lindin bashkë të ashtuquajturat metadata. Metadata janë elementë vital për dokumentet digjitale dhe bashkëshoqëruese të pandashme të tyre gjatë gjithë ciklit të jetës. Ato ruajnë informacion kontekstual, administrative dhe arkivor të

dokumenteve dhe sigurojnë karakteristikat kryesore që duhet të kenë dokumentet arkivore. Mjaft arkiva kombëtare në botë kanë zhvilluar modelet e tyre standarde të metadatave.

Panorama e bërë në këtë artikull synon sensibilizimin e institucioneve arkivore dhe arkivistëve për rolin e tyre në epokën digjitale dhe oportunitetet që ofron teknologjia e informacionit në institucionet arkivore. Proceset e digjitalizimit, indeksimit, sistemet e menaxhimit të dokumenteve etj., padyshim ofrojnë kërkimin e shpejtë dhe mundësinë e aksesit në distancë, por kjo nuk duhet të mjaftojë. Krijimi i përmbajtjes digjitale me karakteristika teknike të cilat do të siguronin ruajtjen afatgjatë të tyre është thelbësore. Kjo në mënyrë të veçantë në kushtet e ndryshimit dhe përmirësimit me ritme shumë të shpejtë të pajisjeve elektronike dhe software-ve përkatës. Dokumentet duhet të mbetem autentike, të përdorshme dhe lexueshme. Nga ana tjetër, arkivistët nuk duhet ta pozicionojnë veten e tyre vetëm në profilin e arkivistit tradicional. Ato duhet të investohen në drejtim të njohjes dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit në proceset e punës arkivore për të mundësuar ndryshimin në formën dhe mënyrën që e kërkojnë arkivat.




Figura 1: Paraqitja në mënyrë vizuale e një dokumenti të digjitalizuar duke përdorur teknikën OCR.

---

1. Saffo, Paul: "Intervista al future", <[www.saffo.com/interviews/infoworld.futures-interview/](http://www.saffo.com/interviews/infoworld.futures-interview/)>

## **BIBLIOGRAFI:**

- Authenticity of Electronic records: A report prepared for UNESCO and the International Council on Archives. [https://www.ica.org/sites/default/files/ICA\\_Study-13-2-Authenticity-of-electronic-records-ICA-Report-to-UNESCO\\_EN.pdf](https://www.ica.org/sites/default/files/ICA_Study-13-2-Authenticity-of-electronic-records-ICA-Report-to-UNESCO_EN.pdf)
- ISAD (G): general international standard archival description: adopted by the Committee on Descriptive Standards, Stockholm, Sweden, 19-22 September 1999, [https://www.ica.org/sites/default/files/CBPS\\_2000\\_Guidelines\\_ISAD%28G%29\\_Second-edition\\_EN.pdf](https://www.ica.org/sites/default/files/CBPS_2000_Guidelines_ISAD%28G%29_Second-edition_EN.pdf)
- Rosiello, Isabella Zanni: *Gli archive nella societa conteporanes*, Milano, 2009.
- Lavoie, Brian: *The Open Archival Information System(OAIS) Reference Model: Introductory Guide* (2<sup>nd</sup> edition), 2014. <https://www.dpconline.org/docs/technology-watch-reports/1359-dpctw14-02/file>
- NISO: A FRAMEWORK OF GUIDANCE FOR BUILDING GOOD DIGITAL COLLECTIONS, 3rd edition 2007. [http://www.niso.org/publications/rp/frame\\_work3.pdf](http://www.niso.org/publications/rp/frame_work3.pdf)
- Topi, Ardiana: "Creating Index of Properties on Archival Documents Using Relational Database", *International Journal of Science and Research* (www.ijsr.net); Volume 5, Issue 10, October 2016.